



PRISHTINA

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.	
Nr. No.	02/1585
Date Date	26. 08 20 26
PRISHTINË/A	



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

Në mbështetje të nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në përputhje me Ligjin e Punës nr. 03/L-212, si dhe bazuar në nenin 8, paragrafi 8.3 të Statutit të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, Prishtinë, me qëllim të rregullimit të politikës së pagave dhe kompensimeve të tjera të ndërmarrjes, konform praktikave të mira të qeverisjes korporative, si dhe në përputhje me gjendjen ekonomike, financiare dhe operative të ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve më datë **26.08.2026** aprovon këtë:

RREGULLORE

MBI PAGAT DHE KOMPENSIMET TJERA NË NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. - Prishtinë

Neni 1.

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Me këtë rregullore rregullohen pagesat mujore dhe kompensimet tjera të cilat iu bëhen punëtorëve të SAP konform obligimeve dhe përgjegjësisë të tyre për kryerjen e detyrave të punës dhe të drejtave për realizimin e të ardhurave për punën e tyre.
- 1.2 Kjo rregullore është nxjerrë në pajtim me legjislacionet në fuqi të Republikës së Kosovës.
- 1.3 Rregullorja vlen dhe do të zbatohet për të gjithë të punësuarit në NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. - Prishtinë.

Neni 2.

Pagesat mujore

- 2.1. Për punën të cilën e kryen punëtori i Stacionit të Autobusëve merr pagën mujore.
- 2.2. Të drejtën për pagë mujore, pagë shtesë, kompensim për punë jashtë orarit, kompensim për punë të natës, si dhe kompensime tjera të parashikuara me këtë rregullore, i punësuari e realizon sipas marrëveshjes së arritur me Stacionin e Autobusëve për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë të përcaktuar me Kontratën e Punës.
- 2.3. Stacioni i Autobusëve obligohet t'i paguajë të gjithë të punësuarve kompensimin e njëjtë për punën të vlerës së njëjtë, kompensimi i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat tjera.

Neni 3.

Kriteret për përcaktimin e pagës bazë

- 3.1. Paga mujore është përcaktuar në bazë të kriterëve përcaktues si:

- Kualifikimi shkollor i nevojshëm për vendin e punës,

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE"
G.J.P "AUTOBUSKA STANICA"
MPE "BUS STATION"

- Ndërlikueshmëria e punës,
- Rëndësia sipas përgjegjësisë në vendin e punës,
- Rrezikshmëria në punë,
- Kushtet e punës dhe intensiteti i punës,
- Përvoja e punës,
- Koeficienti monetar.

Neni 4.

Tabela e kategorizimit të pagave sipas kriterëve për përcaktimin e pagës bazë - shtojcë e kësaj rregulloreje.

Neni 5.

5.1. Pagat mujore paguhen një herë në muaj, deri më datën 5 të muajit të ardhshëm.

5.2. Pagat në Stacionin e Autobusëve paguhen përmes transferit bankar, ndërsa regjistrat mbi pagesat i mban punëdhënësi.

5.3. Në çdo rast, punëtori sipas kërkesës së tij mund të marrë edhe dëshminë mbi pagën mujore.

Neni 6.

Puna provuese

6.1. Punëtori i cili ka themeluar marrëdhënie pune të rregullt në një pozitë të cilën nuk e ka ushtruar më parë, është i obliguar të kalojë nëpër punën provuese.

6.2. Gjatë punës provuese, punëtori merr pagën mujore të plotë për atë vend pune.

Neni 7.

Kompensimi për punë me orar të plotë

7.1. Për punën e kryer me orar të plotë, punëtori do të marrë pagën mujore sipas kategorizimit të vendeve të punës.

7.2. Kalkulimi i pagës bëhet nga zyrtari i pagave dhe kompensimeve tjera dhe bazohet në evidencën e kohës së punës, e cila përgatitet nga Udhëheqësi i tij, ndërsa vërtetohet nga Zyrtari i Burimeve Njerëzore.

7.3. Afati i fundit për dorëzimin e evidencave të punës është data e fundit e muajit.

Neni 8.

Kompensimi për punë shtesë

8.1. Për punën më të gjatë se orari i plotë, në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës,

i punësuarit ka të drejtë për kompensim shtesë në pajtim me këtë rregullore dhe kontratën e Punës.

8.2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje, si më poshtë:

- 2.1. 20% në orar për kujdestari,
- 2.2. 30% në orar për punë gjatë natës,
- 2.3. 30% në orar për punë jashtë orarit,
- 2.4. 50% në orar për punë gjatë ditëve të festave zyrtare,
- 2.5. 50% në orar për punë gjatë fundjavës,
- 2.6. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit përjashton njëra-tjetrën.

8.3. Puna që kalon mbi 40 orë për punëtorët e Stacionit të Autobusëve konsiderohet punë jashtë orarit të punës dhe llogaritet në shkallën 30% mbi bazën.

8.4. Puna jashtë orarit kërkohet me shkrim nga Udhëheqësi i shërbimit, ku kërkesës i bashkangjitet arsyetimi me shkrim. Vendimin për lejimin e punës jashtë orarit e merr Kryeshefi Ekzekutiv. Bazat e organizimit të punës jashtë orarit janë të përcaktuara me LPK.

8.5. Dokumentacioni mbi lejimin e punës jashtë orarit të punës i dorëzohet Sektorit të Burimeve Njerëzore së bashku me evidencën e kohës së punës.

Neni 9.

Kompensimi për punë të natës dhe punë në fundjavë

Orët e punës prej orës 22:00 deri në orën 06:00 konsiderohen punë nate dhe paguhen në lartësinë prej 30% mbi pagën bazë.

Neni 10.

Kompensimi për punë gjatë festave zyrtare

Puna në ditët e festave zyrtare kompensohet me pagesë shtesë në shkallën 50% mbi bazën, ose me ditë të lira në shkallën e njëjtë me pagesën shtesë.

Neni 11.

Kompensimi për pushime dhe zëvendësime

11.1. Pagesa për pushimet vjetore, pushimet statusore, pushimet me pagesë është e barabartë me pagën bazë sipas vendit të punës.

11.2. Kur punëtori, pa pëlqimin e tij, caktohet në vendin tjetër të punës sipas nenit 18, pika 1.1, 1.2, 1.3 të LP-së 03/L-2012, i takon e drejta e diferencës në pagë.

Neni 12.

Kompensimi i pushimit mjekësor

12.1. I punësuar, në rast të sëmundjes, ka të drejtë në pushim mjekësor njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim 100%.

12.2. I punësuar ka të drejtë në pushim pa pagesë, me kërkesën e tij me shkrim të arsyetuar, sipas nenit 40 të LP-së.

12.3. Të punësuarit për pushimin mjekësor për shkak të lëndimit në punë, kompensimi i bëhet në shkallën 70% nga paga mujore.

12.4. I punësuar ka të drejtë kompensimi në pushim mjekësor sipas paragrafit 1.4 të këtij neni në kohëzgjatje prej 10 deri në 90 ditë pune.

12.5. Pushimi mjekësor llogaritet në ditë pune.

Neni 13.

Kompensimi gjatë pushimit të lehonisë

13.1. Për gjashtë (6) muajt e pushimit të lehonisë, pagesa bëhet 70% të pagës bazë nga kompania, ndërsa tre (3) muajt në vijim paguhen me 50% të pagesë mesatare nga Qeveria e Kosovës.

13.2. Të punësuarat kanë të drejtë për tre (3) muaj pushim pa pagesë.

Neni 14.

Kompensimi në rast të mungesës për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë

14.1. Me vendim të organit të autorizuar ose me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i punësuar ka të drejtë të mungojë nga puna, atëherë kur vlerësohet sipas nenit 61 të Ligjit të Punës.

14.2. Gjatë mungesës së përkohshme për shkak të pasigurisë në vendin e punës, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pagës, por jo më gjatë se dyzet e pesë (45) ditë gjatë vitit kalendarik.

Neni 15.

Kompensimi për udhëtime zyrtare

15.1. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit, në shtetet fqinje ose shtetet tjera për qëllime zyrtare dhe në interes të kompanisë, paguhen nga kompania me miratimin e buxhetit nga ana e Bordit të Drejtorëve.

15.2. Për çdo udhëtim duhet plotësuar autorizimi për udhëtim zyrtar. Autorizimin për udhëtime zyrtare për personelin e kompanisë e aprovon Kryeshefi Ekzekutiv, për zyrtarët e lartë, Bordi i Drejtorëve, kurse për anëtarët e Bordit të Drejtorëve njoftohet Komisioni i Aksionarëve.

15.3. Mjetet për udhëtime jashtë vendit do të paguhen në bazë të tarifave të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

Neni 16.

Kompensimi për jetë të ndarë (angazhim jashtë vendit)

16.1. Punëtorët të cilët janë dërguar jashtë vendit për të kryer punë dhe detyra të punës ose shkollim, në gjatësi kohore mbi 30 ditë, do të kompensohen për jetë të ndarë nga familja.

16.2. Vlera e kompensimit caktohet me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, por nuk mund të jetë më e madhe se 50% e pagës mujore të punëtorit.

Neni 17.

Kompensimi gjatë suspendimit

17.1. Punëtori i cili për shkak të shkeljes së obligimeve në punë i është shqiptuar suspendimi si masë disiplinore, si masë parandaluese deri në vendimin përfundimtar të komisionit disiplinor, i kompensohet paga mujore prej 50% të pagës bazë mujore.

17.2. Në rast se pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes disiplinore, punëtori shpallet i pafajshëm dhe lirohet nga përgjegjësia disiplinore, atij do t'i kompensohet pjesa e pagës e mbetur gjatë suspendimit.

17.3. Largimi i përkohshëm nga puna nuk mund të bëhet më gjatë se gjashtë (6) muaj, për të cilën periudhë nuk do të kompensohet.

Neni 18.

Kompensimi për mosshfrytëzimin e pushimit vjetor

18.1. Kompensimi i pushimit vjetor të pashfrytëzuar, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, i kompensohet për aq ditë sa i kanë mbetur pa shfrytëzuar.

18.2. I punësuar, nëse nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor për shkak të nevojave të kompanisë, është i obliguar të ketë dëshmi me shkrim (kërkesën për lejimin e pushimit vjetor të refuzuar nga udhëheqësi i tij) për të shfrytëzuar të drejtën për kompensim gjatë periudhës vijuese.

Neni 19.

(Mos) Kompensime për mungesë nga puna

19.1. Punëtori i cili nuk lajmëron mungesën e tij nga puna e humb të drejtën në pagë për periudhën që ka munguar.

19.1.2. Lëshimi i vendit të punës pa e njoftuar udhëheqësin dhe pa siguruar zëvendësimin.

Neni 20.

Kompensime të veçanta

20.1. Të punësuarve të kompanisë "Stacioni i Autobusëve" u njihet e drejta e kompensimeve si më poshtë:

US
TAN
TIO

RIST
RIST
RIST

- a) Pagesa e shujtës ditore,
- b) Përvoja e punës,
- c) Reprezentacioni / trajnimi / përfaqësimi,
- d) Shpenzimet e udhëtimit, etj.

20.2. Të punësuarve u njihet përvoja e punës dhe e njëjta kompensohet sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj rregullore.

Neni 21.

Kompensime të tjera

21.1. Të punësuarve, me vendim të Bordit të Drejtorëve, mund t'u takojnë kompensime të tjera si më poshtë:

- a) Në rast të vdekjes së një anëtar të ngushtë të familjes,
- b) Në rast të sëmundjeve të rënda,
- c) Stimulim me rastin e Festave Zyrtare,
- d) Bonus në rast tejkalimi të pritshmërive në punë.

Neni 22.

Kompensimi me rastin e shkuarjes në pension

22.1. Të punësuarit, me rastin e shkuarjes në pension, kompania i ndan një kompensim në vlerë prej tri (3) pagave mujore të periudhës së fundit, e përcaktuar sipas nenit 77 të Ligjit të Punës.

Neni 23.

Kompensimi me rastin e vdekjes së punëtorit

Me rastin e vdekjes së punëtorit, familjes së tij i ndahet një kompensim në vlerë të dy (2) page bazë të periudhës së fundit.

Neni 24.

Reprezentacioni / Përfaqësimi

24.1. Të drejtën e reprezentacionit e ka Kryeshefi Ekzekutiv dhe zyrtarët e tjerë me miratimin paraprak të Bordit të Drejtorëve.

24.2. Lartësia e reprezentacionit/përfaqësimit: Kryeshefi Ekzekutiv caktohet si pjesë përbërëse e Buxhetit të Ndërmarrjes dhe aprovohet nga Bordi i Drejtorëve..

Neni 25.

Shpenzimet e telefonisë mobile për Bordin e Drejtorëve dhe punonjësit e kompanisë

25.1. Të punësuarit e Ndërmarrjes "Stacioni i Autobusëve" kanë të drejtën e shfrytëzimit të telefonisë mobile sipas Aneksit 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 26.

Dispozitat përfundimtare

26.1. Në rast mospajtimi në kuptimin e dispozitave, Zyra Ligjore bën interpretimin përfundimtar të tyre.

26.2. Rregullorja mund të rishikohet dhe të ndryshohet nga Bordi i Drejtorëve sipas propozimit të Kryeshefit Ekzekutiv ose me iniciativën e vetë Bordit të Drejtorëve.

26.3. Në rast të mospërputhjes së dispozitave të kësaj rregulloreje me dispozitat e ligjeve në fuqi, përparësi kanë dispozitat ligjore dhe ato zbatohen nga stafi i ndërmarrjes. Përmes Kryeshefit Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve duhet të informohet.

Neni 27.

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret paraprake që lidhen me pagat.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit, pas aprovimit paraprak nga Bordi i Drejtorëve.

Aneksi 1 Tabela e Strukturës së Pagave sipas Koeficientit për Pozitat e Punës

Grupi	Vendi i punës / Pozita	Koeficienti	Vlera e Koeficientit	Paga
I	Mirëmbajtje Higjieniko Sanitare	8.05	70.15	€ 565.00
	Sigurim			
	Nënpunës në Informatat Fonike dhe Vizuele			
	Nënpunës Garderobë			
	Recepionist			
II	Sigurim në Administrat	8.5	70.15	€ 596.28
	Biletar			
III	Depoist	9	70.15	631.35
	Asistent			
	Monitorues i Kamerave të Sigurisë së Objektit			
	Punëtorë në mirëmbajtje teknike dhe higjienike të objekteve dhe aseteve			
	Ndihmës Koordinator			
	Operator Manual i Biletave			
	Likuidator			
	Vozitës			
	Arkivist			

	Elektricitet Objekti			
IV	Dispeçer	9.5	70.15	€ 666.43
V	Koordinator i Shërbimit Teknik	10	70.15	€ 701.50
	Zyrtar i Mbarëvajtjes së Proceseve të Punës			
	Protokolues			
	Arkatar			
	Kontroll i Sistemit dhe Financave			
	Faturist			
	Zyrtar i Kontrollës së Brendshme Inspektuese			
	Kordinator në Mirëmbajtjen e Aseteve dhe Lokaleve			
	Zyrtar për pranimin e Ankesave			
	Asistent Administrativ i KE-se			
VI	Bashëkpuntor i ZBNj	11	70.15	€ 771.65
	Zyrtar Përgjegjës i Sigurimit			
	Kontist			
	Zyrtar i Prokurimit			
	Administrator për Evidencë dhe Udhëheqje të Mjeteve Themelore (MTH);			
	Koordinator i Ndërrimit			
	Zyrtar për Shëndet dhe Siguri në Punë			
	Zyrtar i Shërbimit të Thesarit			
	Zyrtar për hulumtim të tregut dhe implementim të kontratave			
	Teknik i IT-së			
VII	Zyrtar i Kontrollës së Arkave Fiskale dhe Z-Raporteve	11.5	70.15	€ 806.73
	Zyrtar për Mardhnie me Publikun			
	Certifikues i Dokumenteve Financiare			
VIII	Regjistruues dhe Ekzekutues i Pagesave	12	70.15	€ 841.80
	Zyrtar i Burimeve Njerëzore			
	Zyrtari Ligjor			
	Zyrtar për PZHK			
	Zyrtar për Marketing dhe Shitje			
	Zyrtar për Mardhnie me Klient			
	Zyrtar i Transportit			
	Zyrtar për Trajnime			
	Ndihmës Auditor			
	Zyrtar për Matjen e Kënaqshmërisë së Klientëve			
	Zyrtar për Promocion në Rrjete Sociale			
	Zyrtar i IT-së			

IX	Udhëhqesi i Shërbimit të Transportit	12.5	70.15	€ 876.88
	Zyrtar Përgjegjes i Prokurimit			
	Udhëheqës i Shërbimit të Thesarit dhe Financ			
	Udhëheqës i Zyrës Ligjore			
	Udhëheqës i Arkës dhe Përlllogaritës i Pagave			
	Udhëheqës i Kontabilitetit			
	Udhëheqës i Shërbimit Teknik dhe Mirëmbajtjes			
X	Drejtore Administrative	13	70.15	€ 911.95
	Drejtore Operative			
	Drejtore Shërbimeve të Përbashkëta			
	Drejtore Financiare			
	Drejtore Marketingut dhe Digjitalizimit			
	Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv			

Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve
NPL “Stacioni i Autobuseve” sh.a Prishtinë
z. Shaban Brahimaj

